

Performanca e Buxhetit 2018



NË KËTË RAPORT

Periudha raportimit: Janar - Dhjetor 2018

Statusi raportit: Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Belsh gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018

*Ky raport është përgatitur nga Bashkia Belsh me asistencën e Projektit "Bashki të Forta".
Për më shumë informacion kontaktoni Z.Alban Nipolli në adresën alban_nipolli@hotmail.com*

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 19.503 banorë
Rregjistri Civil 32.389 banorë
Sipërfaqja: 196.44 km²
Dendësia: Censuri (2011) 99.28 banorë/km²
Rregjistri Civil 168.88 banorë/km²

Nëndarjet Administrative: 5

(1) Belsh (2) Grekan (3) Kajan (4) Fierzë (5) Rrasë

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



Shpërndarja e anëtarëve:

5	Anëtarë
4	Anëtarë
2	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë

EKZEKUTIVI Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Belsh për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 23.992 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 48.85%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PR, PDIU, PLL.

Kryetari i Bashkisë është **Z. Arif TAFANI**.

departamentet e Bashkisë përfshijnë: finance dhe buxhet, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i teritorrit, mbrojtja e territorit, ligjore, administratë dhe burimet njerëzore, arsim dhe edukim;

EKONOMIA Bashkia e re e Belshit shtrihet pothuajse tërësisht në pllajën kodrinore karstike të Dumresë, një zonë kodrash të buta me bazë gëlqerore mbi të cilat është krijuar një panoramë piktoreske me 85 liqene karstike me një sipërfaqe të përgjithshme prej 14.2 km².


Kodrat e Dumresë qenë në përgjithësi të mbuluara me pyje dushku, por pjesa më e madhe e pyjeve u prenë gjatë kohës së komunizmit për të krijuar hapësirë për toka buke. Një pjesë e banorëve të kësaj zone janë zhvendosur në të kryesisht nga rrethi i Gramshit në periudhën e mbretit Zog, por edhe pas çlirimit të vendit.

SITUATA FINANCIARE

Objektivat e bashkisë Belsh për vitin 2018


- ⇒ Zhvillimi qëndrueshëm ekonomik social si në zonën urbane dhe në atë rurale me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore dhe rritjen e konkureshmërisë rajonale
- ⇒ Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës vendore dhe rajonale për të rritur e përmirësuar akset rrugore në boshtet kryesore, duke përmirësuar shërbimet ndaj komunitetit dhe turizmit në zonat malore
- ⇒ Mbështetje maksimale në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të tyre
- ⇒ Rritja e cilësisë së shërbimeve në të gjitha njësitë administrative me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve atje ku ata banojnë
- ⇒ Rritja e transparencës dhe mirëpërdorimit të fondeve publike në dobi të komunitetit

Fakt 2016, 2017, 2018



Bazim i Informacionit
 Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia e Belsh

2018 VS 2017



Bazim i Informacionit
 Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia e Belsh

SHËRBIMET DHE TË ARDHURAT 2018

Burimet e financimit Buxheti 2018


- ⇒ Transferta e pakushtëzuar ;
- ⇒ Transferta specifike;
- ⇒ Të ardhurat nga burimet e veta;
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017;
- ⇒ Transfertat e kushtëzuara në vlerën;

Buxheti për vitin 2018 = 265.040 mijë lekë

Shërbimet kryesore të ofruara nga bashkia janë


- | | |
|--|------------------------------|
| ⇒ Planifikimi Menaxhimi & Administrimi | ⇒ Kultura & Turizmi |
| ⇒ Ujitja & kullimi | ⇒ Arsimi Parashkollor & baze |
| ⇒ Administrimi i Pyjeve | ⇒ Arsimi Mesem Pergjithshem |
| ⇒ Rruget Runale | ⇒ Emergjencat Civile |
| ⇒ Infrastruktura Rrugore | |
| ⇒ Shërbimet Publike Vendore | |
| ⇒ Ujesjelles Kanalizime | |

Shpenzimet e realizuara për vitin 2018 = 257.616 mijë lekë



TË ARDHURAT 2018


ecuria e të ardhurave të veta



Burimi: Bashkia Belsh, FPT 2019-2021



pesha në buxhet sipas burimit të financimit




Burimi: Bashkia Belsh, FPT 2019-2021

SHPENZIMET

Bashkia Belsh i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje shërbimeve të administrimit dhe infrastrukturës
Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbëjnë rreth 80% të buxhetit janë:

- A. Planifikim, Menaxhim, Administrim
- B. Infrastruktura Rrugore
- C. Shërbimet Publike Vendore
- D. Arsimi bazë dhe parashkollor



Programi me realizimin më të lartë është "Arsimi Parauniversitar", kurse "Rrugët Rurale" ka realizimin më të ulët

Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore në Lekë

Emertimi	Fakt 2017	Plan 2018	Fakt 2018	% Fakt 2018 kundrejt Plan	% Fakt 2018 kundrejt Fakt 2017
Administrimi i Pijevë	612,960	700,324	633,285	90.44%	103.33%
Arsimi Hësor-Pergjithshem	7,672,675	2,198,680	2,198,680	100.00%	28.66%
Arsimi Parashkollor & baze	24,379,961	24,606,080	24,606,080	100.00%	100.93%
Emergjencat Civile	702,213	12,944,203	3,221,637	21.24%	313.00%
Fondi Rezerve & Kontigjenca	0	2,000,000	0	0.00%	
Infrastruktura Rrugore	39,622,570	50,623,152	50,623,152	100.00%	126.25%
Kultura & Turizmi	7,258,781	6,660,000	6,435,270	96.63%	88.66%
Planifikimi Menaxhimi & Administrimi	72,908,358	78,838,234	75,743,477	96.10%	103.89%
Planifikimi Urban	0	90,000	0		
Programet shqiptare	0	10,210,000	0		
Rruget Rurale	75,436,767	16,891,086	11,681,219	69.16%	15.48%
Shërbimet Publike Vendore	46,313,497	42,790,000	44,152,662	93.90%	64.78%
Ujqeslles Kanalizime	0	7,215,600	0	0.00%	
Ujitja & kullimi	17,536,702	9,922,943	9,922,943	100.00%	55.32%
Totali i Shpenzimeve të Mijësve	292,844,484	265,040,302	257,616,884	97.20%	87.97%

Buzeti i Informacionit
 Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia Belsh

SHPENZIMET

Në grafik paraqitet përqindja e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela më poshtë liston investimet më të rëndësishme të bashkisë.

Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik në Lekë



Burimi i Informacionit:
Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia e Elbasanit

Projektet e Investimeve në Lekë



Burimi i Informacionit:
Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia e Elbasanit

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë nëpërmjet treguesve të performancës sipas programeve.

PROGRAM

PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

OBJEKTIVA

Menaxhimi i detyrimeve të prapambetura

Rritja e numrit të bizneseve me 3%


TREGUES PERFORMANCE

TP 1. Trendi i detyrimeve të prapambetura në vite

TP 2. Numri i bizneseve aktiv (trendi vjetor në %)

Realizimi i shpenzimeve : 96% e vlerës së parashikuar (75.743 mijë lekë, 29% e buxhetit)

Punonjës të dedikuar = 67



PROGRAMI

SHËRBIME PUBLIKE VENDORE

Objektivi i programit
Ofrimin e një shërbimi sipas standarteve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë jo vetëm në qytet, por edhe në Njësitë Administrative, me qëllim që ti mundësojë komunitetit krijimin e kushteve normale.

Realizimi i shpenzimeve : 91% e vlerës së parashikuar (40.153 mijë lekë, 16% e buxhetit)


TREGUES PERFORMANCE:

- ◆ **TP 1.** Shtim i elementëve plotësues të lulishteve (stola, kosha, vepra arti)
- ◆ **TP 2.** Pastrimi i kanaleve kulluese
- ◆ **TP 3.** Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëra

Janë vendosur 30 stola dhe 50 kosha mbeturinash

Jane pastruar rreth 27.1 km kanale kulluese.

Janë shtuar sipërfaqet e gjelbëra me 1,700 m²



PROGRAMI

MENAXHIMI RRUGOR

Objektivi i programit

Zhvillimi i një qyteti të qëndrueshëm me cilësi të mirë jetese për banorët e tij.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimi rrugor, i trotuareve dhe shesheve publike vendore. Funkcionimi i transportit publik urban

Programi i menaxhimit rrugor, transportit publik synon investime në infrastrukturën rrugore, përmirësimi i transportit publik dhe implementimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për zhvillimin e territorit. Një nga objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor është drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme si dhe rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe sipas rastit, mbarështimit të sistemeve të tjera territoriale të pandërtueshme.

Realizimi i shpenzimeve :

100% e vlerës së parashikuar (50.023 mijë lekë, 30% e buxhetit)


Punonjës të dedikuar = 17

TREGUES PERFORMANCE:

- ◆ **TP 1.** Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku janë parashikuar zhvillime urbane
- ◆ **TP 2.** Rrugë me cilësi të lartë dhe zhvillim urban me hapësira të reja publike
- ◆ **TP 3.** Ndërtimi i terminalit të autobuzëve

Gjatë vitit 2018 nëpërmjet këtij programi bashkia ka realizuar:

Disa ndërhyrje në rrugët e qytetit (lagjet)
Rritja e numrit të investimeve
Ka filluar ndërtimi i terminalit të autobuzëve



PROGRAMI

KULTURA

Objektivi i programit

Krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale

Bashkia nëpërmjet fondeve të saj synon që ti japë një hapësirë më të plotë jetës artistike dhe kulturore, jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizimin e mëtejshëm të projekteve ekzistuese, të cilat janë kthyer tashmë në një traditë, por edhe duke dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovative. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të Bashkisë Belsh


Realizimi i shpenzimeve : 80% e vlerës së parashikuar (6.435 mijë lekë, 2% e buxhetit)

Punonjës të dedikuar = 5

TREGUES PERFORMANCE:

- ◆ **TP 1.** Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Gjatë vitit 2018 nëpërmjet këtij programi bashkia ka realizuar: 5 koncerte, festivale, opera dhe balet, 8 aktivitete të ndryshme.



PROGRAMI

ARSIMI PARASHKOLLOR

Objektiva:

- ⇒ Ofrimin e kushteve optimale për mirërritjen e fëmijëve
- ⇒ Sigurimin e një infrastrukture arsimore bashkëkohore për nxënësit
- ⇒ Sigurimin e ngrohjes në objektet arsimore.

Bashkia nëpërmjet fondeve buxhetore të saja mbështet veprimtarinë e shërbimit në arsimin parashkollor, duke krijuar kushte sa më optimale për arsimin parashkollor, si dhe duke përdorur burimet financiare në mënyrë eficiente, efektive dhe ekonomike.

Realizimi i shpenzimeve : 100% e vlerës së parashikuar (24.606 mijë lekë) dhe 10% e buxhetit

TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP 1.** Përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit në cilësinë e shërbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe në forcimin e kontrollit të fondeve të planifikuara në buxhetin e arsimit
- ◆ **TP 2.** Ngrohja në objektet arsimore

Gjatë vitit 2018 ka një përmirësim në cilësinë e shërbimeve në pastrim, riparimin e difekteve në sistemin elektrik, hidraulik, punime me dru, meremete të ndërtesave dhe rikonstrukcion i godinave shkollore. Është siguruar ngrohje në objektet arsimore është kryer me dru dhe naftë.



Punonjës të dedikuar
= 34

PROGRAMI

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE EMERGJENCAT CIVILE

Objektivi


Parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, ndërhyrja në shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut.

TREGUES PERFORMANCE


- ♦ **TP 1.** Plotësimi i strukturës së MZSH me personel; pajisje dhe mjete
- ♦ **TP 2.** Mbulimi i gjithë territorit me shërbim e MZSH
- ♦ **TP 3.** Parandalimin e rasteve nga zjarri nëpërmjet rritjes së monitorimit
- ♦ **TP 4.** Evidentimin e dëmëve në rastet e dëmtimit nga zjarri dhe fatkeqësi natyrore

Për vitin 2018 janë ushtruar kontrolle në 50 raste në kategori të ndryshme objektesh e veprimtarish. 1 rast akt-bllokimi. Është ndërhyrë në 50 raste prej të cilave 45 raste për zjarr dhe 5 raste për shpëtim, në aksidente. Në cdo rast është ndërhyrë me profesionalizëm dhe në kohën e duhur.

Realizimi i shpenzimeve : 47% e vlerës së parashikuar (9.222 mijë lekë, 4% e buxhetit)



Punonjës të dedikuar = 14



PROGRAMI

UJITJA DHE KULLIMI

Objektiva



- ⇒ Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i veprave ujtitëse
- ⇒ Investime në rrjetin e kanaleve ujtitëse

Realizimi i shpenzimeve : 100% e vlerës së parashikuar (9.922 mijë lekë)

TREGUES PERFORMANCE

Bashkia ndihmon komunitetin në pjesën rurale për të rritur shfrytëzimin e tokës bujqësore nëpërmjet mirëmbajtjes së sistemit të kanaleve dytësore dhe tercare vaditëse dhe kulluese.

- ♦ **TP 1.** % e sistemit të kanaleve kulluese të pastruara
- ♦ **TP 2.** % e sistemit të kanaleve vaditëse të pastruara



PROGRAMI

UJI I PIJSHËM DHE KANALIZIMET


Objektiva

- ⇒ Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm
- ⇒ Përmirësimi i menaxhimit të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) / shërbimeve sanitare

TREGUES PERFORMANCE

- ♦ **TP1.** Popullsia e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm dhe kanalizime në %
- ♦ **TP2.** Norma e arkëtimit të tarifave në %
- ♦ **TP3.** Norma e mbulimit të kostove të shërbimit nga të ardhurat e realizuara nga tarifa e shërbimit në %
- ♦ **TP4.** Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm në 24 orë

Performanca e shërbimit ujë i pijshëm dhe kanalizime 2016-2018



Kohëzgjatja e u furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)

